



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 prill 2021

Nr.ref.:RK1752/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI144/19

Parashtrues

Tomislav Filipović

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Pronës GSK-KPA-A-276/15, i 13 shkurtit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SE KOSOVËS

përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Tomislav Filipović, me adresë të përhershme në Kurshumli, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga avokati Jeton Osmani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), GSK-KPA-A-276-2015, të 13 shkurtit 2019, në lidhje me vendimin [KPCC/D/A/267/2015] e 30 marsit 2015 të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) në kuadër të Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP).
3. Parashtruesi i kërkesës ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar më 13 maj 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 13 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës nëpërmjet postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 18 shtator 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
8. Më 12 nëntor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrim të kërkesës dhe kërkoi që të dorëzojë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar.
9. Më 13 nëntor 2019, Gjykata Supreme dorëzoi dokumentin e kërkuar.
10. Më 25 mars 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës pretendon se është pronar i pronës me nr. 3086/7, të cilën, sipas tij, e ka fituar përmes blerjes.
12. Më 6 qershor 2007, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në KKPK, duke kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore mbi ngastrën kadastrale nr. 3086/7, e cila gjendet në Komunën e Prishtinës.
13. Më 25 maj 2015, KKPK-ja përmes vendimit refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën e tij pronësore dhe çfarëdo të drejte tjetër mbi pronën e pretenduar. Ndër të tjera, KKPK-ja kishte arsyetuar se parashtruesi i kërkesës nuk figuron në kadastër se ndonjëherë ka qenë pronar i pronës së pretenduar.
14. Më 19 qershor 2015, kundër vendimit të KKPK-së, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme duke pretenduar vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës theksoi se ekzistojnë dëshmitë në shkresat e lëndës që konstatojnë se është pronar i vetëm ligjor i pronës së pretenduar dhe se të njëjtën e kishte humbur për shkak të rrethanave të krijuara gjatë vitit 1998 dhe 1999.
15. Më 13 shkurt 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit (GSK-KPA-A-276-2015), e refuzoi ankesën si të pabazuar. Gjykata Supreme konstatoi se *“Vendimi i KKPK-së, është marrë me vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe mbi këtë bazë edhe ligji material edhe ai procedural janë zbatuar në mënyrën e duhur, me mënyrën e vendosjes duke e refuzuar kërkesën për shkak të mos mbështetjes në dëshmi relevante dhe valide”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNJ-së.
17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Gjykata Supreme e Kosovës dhe Komisioni i kërkesave pronësore të Kosovës nuk i kanë vërtetuar sa duhet faktet relevante përkatësisht historiatin e parcelës dhe provat e tjera të dorëzuara nga paraqitësi i kërkesës lidhur me ngastrën që është objekt i kësaj kërkesë”*.
18. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

21. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

22. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 39 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

23. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pohon se me aktgjykimin e kontestuar janë shkelur neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNJ-së.

24. Fillimisht, Gjykata vëren që parashtruesi në kërkesën e tij, nuk ka ofruar asnjë argument se në çfarë mënyre apo me cilat veprime atij i janë cenuar apo shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës.

25. Po ashtu, Gjykata vëren se lidhur me administrimin e provave, Gjykata Supreme kishte analizuar gjerësisht provat e paraqitura dhe pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës. Së këndejmi, Gjykata Supreme në arsyetimet e dhëna theksoi faktin se “Sekretaria Ekzekutive e KKPK-së ka gjetur ex officio, parcelën e kërkuar në të dhënat kadastrale në Kosovë të regjistruar në emër të palës së tretë që nga viti 1987. Në përpjekjeje shtesë nga sekretaria nga pala kërkuuese është kërkuar të ofroj dëshmi shtesë për të provuar të drejtën e tij, por i njëjti ka dështuar të bëjë një gjë të tillë. Andaj, Komisioni bazuar në dëshminë para tij arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmoj të drejtën e tij pronësore, ose çfarëdo drejte tjetër pronësore për pronën e kërkuar, menjëherë, para, ose gjatë konfliktit të viteve 1998-99, andaj rrjedhimisht kërkesa duhet refuzuar”. Mbi këtë bazë, Gjykata Supreme kishte konkluduar se “Vendimi i kundërshtuar i KKPK-së është marrë me vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike”, dhe

rrjedhimisht kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shkak të mos mbështetjes në dëshmi relevante dhe valide.

26. Në anën tjetër, Gjykata po ashtu vëren se Gjykata Supreme kishte adresuar edhe pretendimin e parashtruesit të kërkesës se prona ishte humbur si rezultat i ngjarjeve të viteve 1998-1999. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet edhe pjesës relevante të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, i cili thekson si në vijim:

“Gjykata Supreme konsideron se faktet e lartpërmendura shpjen në përfundim se humbja e posedimit mbi pronën e kërkuar nuk është rrjedhojë e konfliktit të armatosur të ndodhur gjatë viteve, 1998-1999, andaj pretendimet e palës ankuese edhe në këtë drejtim kur thekson se padryshim se e ka pasur pronën e kërkuar në pronësi në mënyrë ligjore dhe këtë të drejtë e ka humbur për shkak të rrethanave të konfliktit të armatosur, refuzohen si jo të qëndrueshme, sepse nuk provohet me asnjë provë, se pronën e kërkuar pas në posedim dhe pronësi në mënyrë ligjore apo çfarëdo të drejte tjetër pronësore në pronën e kërkuar, në periudhën kohore, menjëherë, para, ose gjatë konfliktit 1998-99”.

27. Bazuar në sa u tha më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar si dhe pse konkluzioni se ai *“nuk ka dëshmuar”* të drejtën e tij pronësore mbi pronën, i cili është dhënë në aktgjykimin e kontestuar, i ka shkelur të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mbrojtje të pronës.
28. Gjykata më tej konsideron se procedurat në KKPK dhe në Gjykatën Supreme ishin të drejta dhe se vendimet ishin plotësisht të arsyetuara, duke shpjeguar se parashtruesi i kërkesës *“nuk ka dëshmuar çfarëdo të drejte pronësore mbi pronën e kërkuar”* (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
29. Për më tepër, parashtruesi nuk ka parashtruar asnjë provë *prima facie*, që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (Shih *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, GJEDNJ, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).
30. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesi nuk e ka ndërtuar pretendimin e tij në baza kushtetuese. Përkundrazi, ai e ka bazuar ankesën e tij në *“vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të fakteve”*. Kjo bie në juridiksionin e gjykatave të rregullta.
31. Në mënyrë konsistente, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës

procedurale dhe materiale (shih rastin e GJEDNJ-së, García Ruiz kundër Spanjës, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KIo6/17, cituar më lart, paragrafi 37; dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 57; dhe KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafi 61).

32. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih rastin e GJEDNJ-së, Pronina kundër Rusisë, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës KIo6/17, cituar më lart, paragrafi 38; KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58 dhe KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafi 62).
33. Prandaj, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtuesi i kërkesës nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të të drejtave kushtetuese në të cilat thirret parashtuesi i kërkesës, dhe se ai nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
34. Si përmbledhje, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 25 mars 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Nexhmi Rexhepi



Kryetaria e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi